



## **VENDIM MBI PAPERANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 28 mars 2019**

**Numri i lëndës: 2016-28**

**S.H.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 28 mars 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 22 shtator 2016.
2. Me shkresën e datës 23 shtatorit 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte regjistruar në Panel.
3. Më 28 qershor 2017, 9 shtator 2017 dhe 17 tetor 2017, Paneli ka kërkuar nga kjo dhe nga ankuesit e tjerë që të japin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre.

4. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve duke dhënë informacion shtesë në lidhje me dy raste, duke përfshirë edhe këtë të tanishëm.
5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli iu ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shifes së Misionit (ShM-së), EULEX-it Kosovë, duke e ftuar atë të parashtrojë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se me datën 26 janar 2018.
6. Vërejtjet e ShM-së u morën më 16 tetor 2018, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.

## **II. PËRBËRJA E PANELIT DHE IDENTITETI I ANKUESIT**

7. Pas dorëheqjes së një prej anëtarëve të tij të përhershëm, Paneli do të mbledhet në këtë çështje vetëm me dy anëtarë, në përputhje me rregullat 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.
8. Ankuesi ka kërkuar që të mos zbulohet identiteti i tij. Duke e shqyrtuar çështjen, në veçanti natyrën e pretendimeve të bëra, Paneli është i bindur që kjo kërkesë duhet të miratohet.

## **III. FAKTET**

9. Më 15 mars 1999, rreth orës 11.00, babai i ankuses kishte dalë nga shtëpia për të shkuar te rrobaqepësi i tij në Mitrovicë. Më vonë ishte parë duke pirë kafe në një kafene në veri të Mitrovicës.
10. Më vonë atë ditë, rreth orës 17.00, ai e kishte marrë me veturë një person të panjohur për në shtëpinë e tij në Zhabarë. Ai dyshohej se ishte konfrontuar dhe rrëmbyer rrugës nga Zhabari për në Mitrovicë nga personat që po vozisnin me disa automjete. Këta persona pretendohet se mbanin armë dhe uniforma me emblema të UÇK-së. Gjoja se ata e kishin marrë babanë e ankuesit në drejtim të fshatit Vaganicë. Babai i ankuesit ishte zhdukur atëherë dhe deri më sot fati i tij mbetet i panjohur.
11. Ankuesi raportuar zhdukjen e tij në Zyrën Rajonale të OSBE-së në Mitrovicë, në KNKK dhe në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë.
12. Më 16 dhjetor 1999, KNKK-ja ka hapur një kërkesë për ta kërkuar babain e ankuesit.

## **IV. ANKESA DHE QENDRIMI I ANKUESIT**

13. Ankuesit i referohen dy të drejtave të veçanta themelore, të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), nën drejtimin e saj procedural, i cili garanton të drejtën themelore të njeriut për jetën dhe ofron obligim për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; Neni 3 i Konventës, i cili garanton të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruës.

14. Në bazë të pretendimeve të ngritura në ankesë, Paneli ka vendosur *proprio motu* të komunikojë dhe të shqyrtojë lëndën sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës, i cili garanton të drejtat me rëndësi potenciale për rastin në fjalë.
15. Të njëjtat të drejta themelore të njeriut garantohen nga një numër i traktateve të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto të drejta janë pjesë e një grupi thelbësor të të drejtave themelore të njeriut të cilat janë të garantuara për të gjithë si një çështje e së drejtës ndërkombëtare zakonore.
16. Duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë familjare ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë dhe ankuesit, Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet si viktimë e dytë e shkeljeve të supozuara dhe se, si e tillë, viktimë potenciale në pajtim me rregullën 25(1) i rregullores së punës së Panelit.

## V. PARASHITESAT E PALËVE

### Ankuesi

17. Siç përmbledhet më lartë, ankuesja pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë duhej të kishte hetuar zhdukjen e të afërmit të tij dhe me faj nuk e ka bërë hetimin në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe të të afërmeve të tij.

### Shefja e Misionit ("ShM")

18. Në letrën e saj të datës 16 tetor 2018, ShM-ja ka parashtruar se si pjesë e transferimit të lëndëve dhe shkresave të lëndëve nga UNMIK-u në EULEX Kosovë gjatë periudhës dhjetor 2008 - mars 2009, raporti i njësisë së policisë së UNMIK-ut për personat e zhdukur (NjPZh) që i referohej babait të ankuesit ishte transferuar në EULEX Kosovë.
19. Përveç kësaj, në nëntor të vitit 2009, një person kishte kontaktuar Njësinë e EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës (WCIU) për të siguruar informacion në lidhje me krimet e dyshuara të kryera prej tij dhe individëve të tjerë dhe duke përmendur babain e ankuesit si një nga viktimat e këtyre krimeve. Nga të dhënat e Misionit, duket se ankuesi nuk ishte njoftuar nga Misioni në atë fazë për ekzistencën e asaj lënde.
20. Në shkurt të vitit 2010, një prokuror i PSRK-së së EULEX-it kishte lëshuar një "vendim për fillimin e hetimit" ndaj atij personi, i cili kishte dhënë informacion në lidhje me këto krime nën disa akuza të krimeve të luftës. Menjëherë pas kësaj, ishte lëshuar një "vendim mbi zgjerimin e hetimit" për t'i zgjeruar akuzat.
21. Në korrik të vitit 2010, ishte lëshuar një "vendim mbi zgjerimin e hetimit" ndaj shtatë të dyshuarve për "krime lufte ndaj popullatës civile" dhe "krime të luftës ndaj të burgosurve të luftës". Babai i ankuesit ishte përmendur në këtë aktgjykim.
22. Emri i babait të ankuesit gjithashtu paraqitet në "Aktvendimin mbi fillimin e hetimit" të nxjerrë në tetor 2010 dhe që lidhet me krimet e luftës ndaj popullatës civile dhe krimet e luftës ndaj të burgosurve të luftës. Në këtë aktvendim, babai i ankuesit ishte përmendur si një prej viktimave që pretendohet se ishte vrarë "në bashkëpunim nga pjesëtarët e UÇK-së" dhe si një nga individët, integriteti dhe shëndeti fizik i të cilëve ishte shkelur përmes rrahjeve të

përsëritura që pretendohet se ishin kryer gjoja se nga UÇK-ja, përderisa ishte në mbajtje në një objekt të UÇK-së në Kleçkë diku midis mesit të marsit dhe fillimit të prillit 1999.

23. Në gusht të vitit 2010, me kërkesë të prokurorit të PSRK-së të EULEX-it, personi i cili kishte kontaktuar me EULEX-in dhe kishte dhënë informata në vitin 2009 ishte shpallur “dëshmitar bashkëpunues” nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë.
24. Në korrik 2011, Prokurori i EULEX-it i PSRK-së kishte paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë një aktakuzë për “krime lufte ndaj popullatës civile dhe të burgosurve të luftës” ndaj dhjetë (10) të pandehurve. Emri i babait të ankuesit ishte përmendur si viktimë në atë aktakuzë. Të afërmit e tij thuhet se ishin thirrur si të dëmtuar gjatë proceseve gjyqësore.
25. Në një datë të pasaktësuar, procedurat ishin ndarë në dy grupe të të pandehurve.
26. Në mars 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë në një trup gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës kishte lëshuar një aktgjykim ndaj grupit të parë të të pandehurve, duke i liruar nga të gjitha akuzat.
27. Në maj 2012, një tjetër trup gjykues me dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar të Kosovës kishte liruar të pandehurit e tjerë.
28. Pas apelimeve të prokurorit të PSRK-së të EULEX-it në nëntor dhe dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës i kishte anuluar aktgjykimet dhe i kishte kthyer rastet ndaj dhjetë të pandehurve në rigjykim.
29. Në shkurt të vitit 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës kishte lëshuar një aktgjykim për ribashkimin e lëndëve.
30. Në shtator 2013, Gjykata Themelore e Prishtinës në një trup gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës përsëri kishte liruar si të pafajshëm të gjithë të pandehurit. Në atë aktgjykim, emri i babait të ankuesit ishte përmendur përsëri si viktimë. Ky aktgjykim ishte apeluar pa sukses dhe ishte konfirmuar në janar 2016.
31. Në maj të vitit 2017, Gjykata Supreme e Kosovës në një trup gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës kishte hedhur poshtë si të pabazuar një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga prokurori në gusht 2016.
32. ShM-ja nuk ishte në gjendje të përcaktojë nëse ankuesja dhe/ose të afërmit e tjerë të viktimës ishin përfshirë në hetimin e këtij rasti nga EULEX-i Kosovë. ShM-ja ka treguar se ajo nuk ishte në dijeni të ndonjë hetimi që ishte duke vazhduar, që lidhej me zhdukjen e babait të ankueses.
33. Sa i përket pranueshmërisë së këtij rasti, ShM-ja vë në pah rregullën 25, paragrafi 1, të rregullores së punës së Panelit, e cila përjashton kompetencën e Panelit mbi veprimet e gjyqësorit të Kosovës. ShM-ja nuk e konteston pranueshmërinë e rastit në aspekte të tjera. Megjithatë ajo thekson se sipas mendimit të saj “Policia e EULEX-it Kosovë, autoritetet prokuroriale dhe gjyqësore kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për të hetuar dhe ndëshkuar autorët e krimeve nga të cilët [babai i ankuesit] ishte viktimë. ShM-ja shton se Misioni:

“Shpreh keqardhje të thellë që përkundër përpjekjeve të saja, ankuesi dhe anëtarët e tjerë të ngushtë të familjes së të zhdukurve nuk e kanë fituar drejtësinë”.

Së fundmi, ShM-ja tregon se meqë Misioni konsideron që ankesa duhet të shpallet e papranueshme, ajo nuk do të paraqesë vërejtje mbi bazueshmërinë.

34. Në parashtrimet e saj, ShM-ja gjithashtu ka dhënë një përshkrim të hollësishëm mbi procesin kompleks të përfshirjes në transferimin e dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u tek Misioni dhe mbi punën e përfshirjes në rishikimin, organizimin dhe kategorizimin e lëndëve dhe shkresave të lëndëve.
35. Sa i përket përpjekjeve të Misionit për të hetuar lëndët e “zhdukjeve me forcë”, ShM-ja ka vënë në dukje se nocioni i “zhdukjes me forcë” në vetvete nuk k qenë pjesë relevante e kuadrit normativ që përcakton punën e tij dhe se krimet e tilla ishin hetuar dhe ndjekur si lëndë të krimeve të luftës.

## VI. VLERËSIMI I PANELIT

*Mandati i Panelit (Rregulli 25, paragrafi 1 i rregullores së punës) dhe kufizimet e natyrshme të vendosura në Mision në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut*

36. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
37. Para shqyrtimit të ankesës në bazë të meritave të saj, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
38. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
39. Paneli tashmë ka vendosur që veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K deri T kundër EULEX-it*, 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015, para 43, *Krić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23, *Y. kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35). Ky është rasti i veprimeve pozitive ose i dështimeve të fajshme.
40. Gjithashtu për qëllimet e tanishme duhet të theksohet që të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër më të rëndësishmet e të gjitha të drejtave themelore. Ato prekin interesat thelbësore të viktimave të supozuara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e “zhdukjes me forcë” përbën një shkelje tejet të madhe të këtyre të drejtave. Kjo është reflektuar *ndër të tjera* në faktin se “zhdukja me forcë” tani konsiderohet dhe karakterizohet si krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (Statuti i

Romës, neni 7(1)(i)) dhe në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë Speciale (Ligji nr. 05/L-053) (Neni 13(1)(i)).

41. Të gjitha arsyet e lartpërmendura janë marrë në konsideratë gjatë vendosjes rreth pranueshmërisë së kësaj lënde.
42. Bazuar si më sipër, Paneli është i bindur që Misioni ka qenë kompetent në ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv për të hetuar rrethanat që kishin të bënin me zhdukjen e babait të ankueses dhe në të vërtetë e kanë bërë atë. Konsideratat që kanë të bëjnë me sfidat dhe vështirësitë e përfshira në hetimin e një rasti të tillë, në kontekstin e veçantë të Kosovës pas konfliktit, mund të jenë relevante lidhur me vlerësimin e Panelit rreth meritave të ankesës. Paneli i fton palët të trajtojnë këtë çështje në parashtrimet e tyre nëse konsiderohet e rëndësishme për zgjidhjen e ankesës.
43. Paneli gjithashtu thekson që Misioni nuk ka pushur së qenuri kompetent për të hetuar këtë rast deri më 14 qershor 2018. Deri në atë pikë, ai kishte autoritetin ekzekutiv që të hetonte dhe të vazhdonte të hetonte këtë çështje. Kjo do të përfshinte, *ndër të tjera*, periudhën që pasoi shfaqësimin përfundimtar të dhjetë të pandehurve që ishte konfirmuar në janar 2016, gjatë së cilës mund të ishte ndërmarrë hetimi i çështjes - nëse jo i të pandehurve të njëjtë.
44. Prandaj, Paneli është i bindur që është kompetent *prima facie* për të shqyrtuar veprimin e Misionit në lidhje me këtë çështje. Megjithatë në përputhje me rregullën 25, paragrafi 1 i rregullores së vet, Paneli nuk është kompetent për të shqyrtuar veprimet e gjyqësorit në lidhje me atë rast.

*Lidhjet e mjaftueshme kohore me veprimin themelor dhe kompetencën e ratione temporis të Panelit*

45. Paneli duhet të vendosë nëse lënda ishte e pranueshme në kohën kur ajo ishte parashtruar në Panel. Për arsyet e përshkruara më poshtë, Paneli është i bindur që ishte.
46. Së pari, Paneli thekson që Misioni nuk e konteston që lënda është mjaft e lidhur me mandatin e Misionit dhe se Paneli do të jetë kompetent *ratione temporis* për të adresuar këtë çështje.
47. Së dyti, prania e lidhjes së nevojshme kohore gjithashtu është e dukshme nga fakti i përfshirjes së drejtpërdrejtë të Misionit me këtë rast – përmes hetimit dhe më pas ndjekjes së një numri të të dyshuarve.
48. Së treti, Paneli thekson që shkeljet e ankimuara konsiderohen si shkelje në vazhdim e sipër ose të vazhdueshme të të drejtave themelore në fjalë. Në përgjithësi shih D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për Pranueshmëri, 30 Shtator 2015, par. 78; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 shtator 2015, par. 35 dhe 42. Shih gjithashtu, në kontekstin e nenit 3, GjEDNJ, Kurt kundër Turqisë, Aktgjykimi i datës 25 maj 1998, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998 III, par. 130-34; Khadzhaliev dhe të tjerët kundër Ruisë, Aplikacioni nr. 3013/04, aktgjykimi i 6 nëntorit 2008, par. 120-121; Timurtas kundër Turqisë, Aplikimi nr. 23531/94, Aktgjykimi i datës 13 qershor 2000, par. 95; dhe Rezoluta nr. 828 e vitit 1984, paragrafi 3 (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës).

49. Po ashtu Paneli thekson që derisa ai kishte parashtruar ankesën e vet në Panel, ankuesi nuk ishte korrigjuar zyrtarisht nga asnjë autoritet që kishte të bënte me të se ata nuk do të vazhdonin të hetonin këtë rast në mënyrë që të sigurohej se fati i të afërmit të tij do të vërtetohej dhe autorët do të silleshin para drejtësisë.
50. Në këto rrethana, Paneli është kompetent *ratione temporis* për të shqyrtuar këtë ankesë dhe është i bindur se ankuesi i është përmbajtur afatit gjashtë mujor, të përcaktuar nga rregullat në të cilat duhet të parashtrohet ankesa.
51. Paneli thekson se është kompetent *ratione temporis* që t'i shqyrtojë veprimet e Misionit deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni pushon së pasuri përgjegjësi ekzekutive mbi këtë rast. Megjithatë aktivitetet e kryera pas kësaj date mund të jenë relevante për të vlerësuar shkallën në të cilën mund të thuhet se Misioni ka përmbushur detyrimet e veta ndaj të drejtave të njeriut.

#### *Kompetenca e Panelit ratione materiae*

52. ShM-ja në parashtrimet e veta ka theksuar se Paneli nuk ishte kompetent për të vlerësuar veprimin e gjyqësorit të Kosovës. Kjo është e saktë dhe në përputhje me kufizimet e vendosura në mandatin e Panelit. ShM-ja nuk ngrit ndonjë kundërshtim tjetër - *ratione materiae, personae ose temporis* - lidhur me kompetencën *ratione materiae* të Panelit lidhur me këtë ankesë.
53. Paneli është i bindur që, siç ilustron me këtë rast, Misioni ishte kompetent për të hetuar dhe ndjekur penalisht veprimet e “zhdukjes me forcë” gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Shih, p.sh., D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për Pranueshmëri, 30 Shtator 2015; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 Shtator 2015; L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, vendimet dhe të gjeturat, 11 nëntor 2015.
54. Paneli thekson që veprimet e zhdukjes me forcë mund të kualifikohen ligjërisht ndër të tjera si krime lufte, krime kundër njerëzimit ose krime etnike, të cilat Misioni në parim ishte kompetent për të hetuar dhe ndjekur penalisht. Në përgjithësi shih nenin 3 (d) të veprimit të përbashkët të Këshillit. Shih gjithashtu Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 44-46. Në *D.W. e të tjerë*, Paneli ka thënë në paragrafin në vijim, e cila gjithashtu do të zbatohet në këtë lëndë:

"Ka pasur një mundësi shumë reale që këto krime dhe shkeljet shoqëruese të të drejtave të ishin bazë e konsideratës etnike ose fetare duke shkuar më tej në territorin e juridiksionit mbi të cilin Misioni ka kompetencë. Në një mjedis të pas konfliktit ku marrëdhëniet etnike dhe fetare mund të jenë ende të tensionuara dhe të brishta, rastet e tilla kanë përparësi të dukshme hetimore. Përsëri nga procesverbali kjo nuk duket se ishte konsideruar relevante nga ana e Misionit në përcaktimin e “rrethanave të jashtëzakonshme”.

D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., dhe I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, par. 83 e *tutje*, në veçanti par. 85.

55. Paneli gjithashtu duhet të përsërisë se hetimi i këtyre lëndëve nuk ishte vetëm pjesë e mandatit ekzekutiv të Misionit, por ishte element thelbësor dhe bazë e tij. Kështu në lëndën

*L.O. kundër EULEX-it*, Paneli ka theksuar që “mund që mos të ketë kundërshtime se hetimi i fatit të të zhdukurve - pavarësisht prej përkatësisë fetare apo etnike - duhet të jetë dhe duhet të mbetet prioritet operativ për EULEX-in si Misioni i Sundimit të Ligjit, që për të cilin duhet t’i sigurohen burime të duhura’ (LO kundër EULEX-it, lënda nr. 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 47).

56. Bazuar si më sipër, Paneli është i bindur që kjo çështje deri më 14 qershor 2018 ka hyrë brenda kompetencës *ratione materiae* të Misionit në ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv. Siç është cekur më lartë, në përputhje me rregullin 25, paragrafi 1, i rregullores së punës së Panelit, kjo nuk përfshinë asnjë prej veprimeve dhe aktivitetet që i atribuohen gjyqësorit të Kosovës.

## **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJEZËRI**

Pa paragjykuar meritat e çështjes **SHALL TË PRANUESHME** ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

**KËRKON NGA PALËT QË T’IU PËRGJIGJEN PYETJEVE VIJUESE** si pjesë e parashtresave të tyre mbi meritat e këtij rasti, pa paragjykuar pikëpamjet dhe konkluzionet e Panelit:

- i. Për Misionin:
  - a. Pse ankuesi nuk ishte i informuar nga Misioni për ekzistencën, karakterin dhe rrjedhën e hetimit?
  - b. Pas lirimit të të gjithë të pandehurve në këtë rast si të pafajshëm, a janë bërë përpjekje të tjera hetimore për të identifikuar dhe ndjekur penalisht ata që janë përgjegjës për zhdukjen e të afërmit të ankueses? Nëse jo, pse? A është bërë ndonjë përpjekje, në veçanti që të kërkohen të merren prova të tjera?
  - c. Në bazë të njohurive të Misionit, a janë autoritetet e Kosovës ende duke hetuar këtë rast? Nëse po, në cilën fazë gjendet? A është duke e monitoruar këtë lëndë Misioni?
  - d. A ka ndërmarrë Misioni ndonjë hap (para ose që nga 14 qershori 2018) në ushtrimin e mandatit (të ri) të tij për të siguruar që kjo lëndë të sqarohet nga autoritetet vendore?
  - e. Aty ku bëhet e qartë për Misionin që autoritetet vendore nuk janë në gjendje apo nuk dëshirojnë të hetojnë një çështje penale, cilat janë kompetecat dhe mjetet e Misionit (nëse ka) për të kërkuar që të sigurohet se është vendosur drejtësia dhe viktimat të kenë qasje në një zgjidhje juridike lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre?
  - f. A ka bërë shkelje apo ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankueses sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës?
- ii. Për ankuesen:



- a. A jeni përfshirë në procedurën kundër dhjetë të pandehurve? Nëse po, a keni pasur ndonjë kontakt me Misionin e EULEX-it apo përfaqësuesit e tij në atë kontekst?
- b. Pas lirimit të këtyre të pandehurve, a keni pasur ndonjë kontakt të mëtejshëm me EULEX-in Kosovë në lidhje me këtë çështje?
- c. A ka bërë shkelje apo ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
- d. Cilat janë pasojat personale, financiare dhe emocionale – që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

**KËRKON NGA PALËT** që të paraqesin çfarëdo parashtrese lidhur me meritat e këtij rasti jo më vonë se me datën 20 maj 2019 ose nëse nevojitet më shumë kohë, të bëhet një kërkesë me kohë në mënyrë që të zgjatet afati deri në atë datë.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX  
Kryesues



Anna BEDNAREK  
Anëtar